

URDHËR
Nr.570, datë 15.12.2010

**PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR TRANSFERIM STUDIMESH, NË
CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË
DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 33, 35 dhe 36 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në shkronjën “c” të pikës 1, pikat 3, 10, 13 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të pranimit për transferim studimesh në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2010-2011, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, i ndryshuar, mbështetur në kërkesën e institucioneve publike të arsimit të lartë.

2. Kuotat e transferimit të studimeve dhënë institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Kuotat e transferimit të studimeve, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të shfrytëzohen edhe për transferime nga institucionet private të arsimit të lartë, drejt institucioneve publike të arsimit të lartë, deri në masën 30% të kuotës për transferim të përcaktuar për çdo program studimi.

4. Kuotat e dhëna institucioneve publike të arsimit të lartë për transferime, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të shpërndahen, duke respektuar, nga këta të fundit, kriteret e vendosura në përputhje me aktet nënligjore dhe të publikuara më parë në vende të dukshme prej tyre.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Tabela nr.1

**TABELA E KUOTAVE PËR TRANSFERIM STUDIMESH NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME**

	Programi i studimit	IAL				
		UE	UBT	UGJ	USH	Shuma
1	Histori				2	2
2	Gjeografi				2	2
3	Histori-gjeografi			3		3
4	Gjuhë-letërsi				2	2
5	Cikli i ulët				3	3
6	Cikli i ulët parashkollor				2	2
7	Matematikë-fizikë	1		3		4
8	Matematikë				2	2
9	Fizikë				2	2
10	Biologji-kimi			3	2	5
11	Drejtësi				20	20
12	Administrim publik			4		4
13	Administrim biznes	10			3	13
14	Financë-kontabilitet	5		4	2	11
15	Turizëm			4	2	6
16	Prodhim bimor		10			10
17	Agromekanizim		10			10
18	Hortikulturë		10			10
19	Mbrojtje bimësh		10			10
20	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi		10			10
21	Zootekni dhe biznes blegtoral		19			19
22	Menaxhim agrobiznesi		10			10
23	Ekonomi dhe politikë agrare		10			10
24	Financë-kontabilitet		10			10
25	Inxhinieri agroushqimore		5			5
26	Vreshtari-enologji		5			5
27	Inxhinieri pyjore		5			5
28	Inxhinieri përpunim druri		5			5
	Gjithsej	16	119	21	44	200